

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjiilan- dega në Kamenicë, përmes gjyqtarës së vetme Valbonë Dërvodeli, me sekretaren juridike Emine Zubaku, në çështjen penale kundër të akuzuarit, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi, të parashikuar nga neni 236 parag.1 nënparag. 3 të KPK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së PPK-së nga Gjiilani PP.nr.3036/2008 e dt.09.01.2009, në shqyrtimin e hapur gjyqësor, më dt.30.07.2014 komunikoi, ndërsa më dt.14.08.2014 përpiloi këtë.

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

Në bazë të nenit 363 .pika 1.3 të KPPRK-së,

REFUZOHET AKUZA

Për shkak se në periudhën kohore; korrik 2001 - tetor 2003, në cilësi te personit përgjegjës-drejtorit te “Ndërmarrjes Publike Komunale”, në Kamenicë, me qëllim të realizimit të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për këtë kompani, ka paguar vetëm pjesërisht detyrime tatimore, me çka e ka dëmtuara buxhetin e Republikës së Kosovës, në lartësi prej 135.631.05 €, për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit të ndjekjes penale.

-me çka kishte për të kryer, vepër penale keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi të parashikuar nga neni 236 par..1 nën parag. 3 të KPK-së.

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore –juridike , udhëzohet në kontest civil.

Në bazë të nenit 364 pika .1.3 të KPPRK-së

LIROHET NGA AKUZA

Për shkak se në periudhën kohore; nëntor 2003 - dhjetor 2006, në cilësi te personit përgjegjës-drejtorit te “Ndërmarrjes Publike Komunale”, në Kamenicë, me qëllim të realizimit të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për këtë kompani, ka paguar vetëm pjesërisht detyrime tatimore, me çka e ka dëmtuara buxhetin e Republikës së Kosovës, në lartësi prej 135.631.05 €.

-me çka kishte për të kryer vepër penale keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi, të parashikuar nga neni 236 par.1 nënparag. 3 të KPK-së.

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore –juridike , udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në ngarkesë të mjeteve bugetore të kësaj gjykate .

A r s y e t i m

Prokuroria Publike komunale në Gjilan, me aktakuzë PP.nr.3036/2008 prej dates 09.01.2009, ka akuzuar, për shkak të veprës penale, keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 parag. 1 nënpara.3 të KPK-së, pranë të cilës ka mbetur edhe në fjalën e tij përfundimtare me propozim që i akuzuari të deklarohet fajtor dhe të dënohet në përputhje me ligjin.

Gjykata në shqyrtimin e mbajtur kryesor, pas shikimit të shkresave të lëndës, dëgjimit të dëshmitarëve ka vërtetuar se vepra penale për të cilën akuzohet, në dispozitivin - I - të këtij aktgjykimi është përfshirë me parashkrim absolut, ngase sipas të dhënave në akuzë kjo veprë penale është kryer në periudhën kohore prej korrikut të vitit 2001 deri në tetor të vitit 2003, prej nga rezulton se nga data e kryerjes së veprës penale e deri në ditën e marrjes së këtij aktgjykimi kanë kaluar mbi 10 vite .

Me dispozitën e nenit 106 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, shprehimisht parashihet se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 5 vite nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në pesë vite burgim (parashkrimi i ndjekjes penale).

Po ashtu me dispozitën e nenit 107 parag. 8 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, shprehimisht parashihet se ndalohet në çdo rast ndjekja penale kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (parashkrimi absolut).

Duke pasur parasysh se nga kryerja e veprës penale kanë kaluar më tepër se 10 vite, kurse procedura penale brenda këtij afati nuk ka mundur të përfundojë me aktgjykim të formës së prerë, gjykata mbështetur në dispozitat e cekura më lartë ka konstatuar se ndjekja penale në rastin konkret është përfshirë në parashkrim absolut.

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore –juridike , udhëzohet në kontest civil.

Për shpenzimet e procedurës penale gjykata ka vendosur që ato të bien në barrë të mjeteve bugjetore të kësaj gjykate, në kuptim të nenit 454 parag. 1 i KPPRK-së.

Nga të shtruarat më lart , në kuptim të nenit 363 pika 1.3 të KPPRK-s, u vendos si në pikën I.të dispozitivit të aktgjykimit.

Sa i përket veprës penale nga dispozitivit II i këtij aktgjykimi , gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Nuk është kontestuese se në këtë periudhë kohore nuk janë paguar obligimet tatimore të parashikuara me ligj dhe i është shkaktuar dëm buxhetit të Republikës së Kosovës në shumën e përshkruar në dispozitiv , kjo gjendje është vërtetuar nga ana e ekspertit financiar mirëpo nga nëntori 2003 e tutje nuk ishte i akuzuari drejtor i ndërmarrjes dhe nuk mban përgjegjësi për mos pagesën e këtyre obligimeve tatimore . NPK-ja në Kamenicë, prej nëntorit 2003 e tutje është transferuar në kuadër të Ndërmarrjes Regjionale për mbeturina të ngurta në Gjilan “Hidromorava” dhe është trajtuar si Dega (njësia) në Kamenicë .

Gjykata erdhi në përfundim se i akuzuari nuk ka qenë përgjegjës për pagesën e tatimit në këtë periudhë, (dispozitivi II i këtij aktgjykimi) pasi analizoi provat materiale si: Përshkrimin e biznesit, kontrollin në praktikë dhe

shtrirjen e tij, shënimin për aktivitet të inspektorit të datës 18.09.2006, kontratat e punësimit të prezentuara nga i akuzuari në mbrojtjen e tij si menagjer i njësisë punuese Higjiena-Kamenicë, poashtu analizoi edhe deklaratën e dëshmitarit i cili deklaroi se ka qenë përgjegjës deri më 30.09.2003 pasi kompania është ndarë në dy pjesë edhe ate sektori i ujit dhe sektori i higjienës ku të njëjtat janë inkorporuar në kompanit rajonale të Gjilanit.

Meqenëse nuk është vërtetuar se në periudhën kohore nëntor 2003 gjer dhjetor 2006 mospërmbushja e detyrimeve tatimore ndaj ATK-së nuk ka ardhë me fajin e të akuzuarit , gjykata e ka liruar të akuzuarin nga akuza , në bazë të nenit 364.pika 1. 3 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 454 par.1 të KPPRK-së, është vendosur që shpenzimet e procedurës të bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Vendimi për ta udhëzuar të dëmtuarin për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është bazuar në nenin 463 par.3 të KPPRK-së.

Nga të shtruarat më lart , në kuptim të nenit 364 pika 1.3 të KPPRK-s, u vendos si në pikën II.të dispozitivit të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN- DEGA NE KAMENICE,

Më datën 14.08.2014.P.nr.07/2009

Sekretarja juridike,

Gj y q t a r j a,

Emine Zubaku,d.v.

Valbonë Dërvodeli,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej
15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së
Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.